


Bizneset e Huaja në Shqipëri 2014-2016

INSTAT



Dhjetor, 2017

Parathënie dhe Mirënjohje

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, hartoi për herë të parë një publikim të veçantë për treguesit kryesorë të ndërmarrjeve me pronësi të huaj dhe të përbashkëta që operojnë në Shqipëri. Duke iu referuar periudhës nga viti 2014-2016, statistikat në lidhje me ndërmarrjet private të huaja dhe të përbashkëta (shqiptare dhe të huaja) synojnë të monitorojnë situatën, strukturën, intensitetin e tregtisë dhe performancën e tyre brenda territorit të Shqipërisë.

Në strategjinë e re të komunikimit, INSTAT është orientuar që të përmbushë nevojat e përdoruesve duke targetuar grupe të ndryshme përdoruesish. Ky publikim pasqyron disa nga kërkesat themelore dhe nevojat e disa grupeve të përdoruesve për të dhënat mbi ndërmarrjet e huaja dhe aktivitetin e tyre ekonomik në Shqipëri.

Ky publikim i dedikuar, paraqet me anë të shifrave realitetin ekonomik në vend si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencor dhe akademikëve në Shqipëri.

Ky publikim do të ishte i pamundur pa bashkëpunimin e ndërmarrjeve për t'ju përgjigjur pyetësorëve të organizuar nga INSTAT dhe të dhënave administrative të siguruara nga institucionet e tjera. Kontributi i Bankës së Shqipërisë për të dhënat e Investimeve të Huaja Direkte (IHD), është një vlerë e shtuar në këtë publikim.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe politikë-bërësit, rrit përgjegjësinë e INSTAT për hartimin e publikimeve të veçanta dhe informacioneve statistikore që do të shërbenin për të kuptuar më mirë realitetin ekonomik në mënyrë që të ballafaqohemi me sfidat e së ardhmes.

INSTAT gjithmonë do ofrojë partneritet të vazhdueshëm dhe një bashkëpunim të frytshëm, ashtu siç e dëshmon dhe ky botim.

Delina IBRAHIMAJ, PHD

Drejtor i Përgjithshëm, INSTAT

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Hyrje..... | 5 |
| A. Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta | 6 |
| Tabela 1: Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta..... | 6 |
| Fig.1 Struktura e ndërmarrje të huaja e të përbashkëta sipas shteteve, 2016..... | 6 |
| Fig.2: Ndërmarrje të huaja dhe të përbashkëta sipas shteteve..... | 7 |
| Tab. 2 Ndërmarrje të huaja dhe të përbashkëta sipas shteteve..... | 8 |
| Tab. 3 Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta sipas pronësisë dhe rajoneve..... | 9 |
| Tab. 4 Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta sipas aktiviteti ekonomik dhe rajoneve | 9 |
| Tab. 5 Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta sipas madhësisë së ndërmarrjes | 10 |
| B. Treguesit kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta..... | 11 |
| Fig.3: Përqindja e treguesve kryesorë në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët ndaj ndërmarrjeve shqiptare | 11 |
| Tab. 6 Struktura e treguesve kryesorë në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët sipas shteteve | 12 |
| Fig. 4 Struktura e punësimit në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët..... | 12 |
| Fig.5 Struktura e shitjeve neto në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët..... | 13 |
| Tab. 7 Struktura e treguesve kryesorë sipas aktivitet ekonomik..... | 14 |
| Fig.6 Struktura e punësimit sipas rajoneve për çdo aktivitet ekonomik, 2016 | 15 |
| Fig.7 Struktura e shitjeve neto sipas rajoneve për çdo aktivitet ekonomik, 2016..... | 15 |
| Fig.8 Struktura e investimeve sipas rajoneve për çdo aktivitet ekonomik, 2016 | 16 |
| Tab. 8 Struktura e shitjeve për ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët sipas shteteve për çdo aktivitet ekonomik | 17 |
| Fig.9 Përqindja e treguesve kryesorë sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2016 | 18 |
| C. Investimet e Huaja Direkte (IHD) | 19 |
| Tab. 9 IHD, Stoku sipas vendeve (mil Euro) | 19 |
| Tab. 10 IHD, Flow sipas vendeve (mil Euro)..... | 19 |
| Tab.11 IHD, Stoku sipas aktiviteteve (mil Euro)..... | 20 |
| Tab. 12 IHD, Flow sipas aktiviteteve (mil Euro) | 20 |
| D. Tregtia e Mallrave sipas Ndërmarrjeve..... | 21 |
| Tab. 13 Numri i ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta sipas vendeve..... | 21 |
| Tab.14 Eksportet dhe importet e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në totalin e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, sipas vendeve | 22 |

| | |
|---|----|
| Tab. 15 Tregtia e Jashtme e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në totalin e ndërmarrjeve eksportuese/importuese, sipas aktivitetit ekonomik dhe numrit të të punësuarve..... | 23 |
| Tab. 16 Tregtia e Jashtme e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta nga BE në totalin e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, sipas aktivitetit ekonomik dhe numrit të të punësuarve. | 23 |

Hyrje

Ky material i përgatitur nga INSTAT, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, publikohet për herë të parë, duke përfshirë të dhënat për vitet referencë 2014-2016 dhe do të jetë publikim i vazhdueshëm me frekuencë vjetore.

Materiali përbëhet nga katër kapituj. Kapitulli i parë paraqet numrin e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta që operojnë në Shqipëri, të ndara sipas llojit të pronësisë, vendit të investitorit, aktivitetit kryesor ekonomik dhe madhësisë.

Kapitulli i dytë shpreh rolin dhe ndikimin e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në treguesit e punësimit, shifrës së afarizimit (turnover) dhe investimeve.

Kapitulli i tretë paraqet lëvizjen e Investimeve të Huaja Direkte (IHD), Flow dhe Stock, sipas vendeve dhe veprimtarive që i referohen të dhënave nga Banka e Shqipërisë.

Kapitulli i katërt fokusohet në strukturën e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në eksportet dhe importet në ekonominë e Shqipërisë.

Duke iu referuar periudhës 2014-2016 statistikat në lidhje me ndërmarrjet private të huaja dhe të përbashkëta synojnë të monitorojnë situatën, strukturën, intensitetin e tregtisë dhe performancën e tyre brenda territorit shqiptar.

Gjetjet kryesore të shkruara në material tregojnë që në vitin 2016, ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta kanë punësuar 16% të totalit të punësimit dhe kanë kontribuar me 22,7 % në totalin e xhiros vjetore.

Ndërmarrjet me pronësi 100% të huaj mbulojnë 71,4 % të totalit të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, ndërsa ndërmarrjet e përbashkëta me mbizotërim të huaj mbulojnë 14 % të tyre.

Në fund të vitit 2016, numri të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta u ul me 5,1 %, krahasuar me vitin 2015. Për vitin 2016, peshën më të mëdha të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta e japin Italia dhe Greqia me 56,5 % të ndërmarrjeve, 60,5 % të punësimit, 61,1 % të eksporteve dhe 47,5 % të importeve.

A. Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta

Në vitin 2016 ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë 5,637 , ndërsa në fund të vitit 2015 ishin 5,939, duke shënuar një rënie me 5,1%.

Tabela 1: Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta


| Pronësia | 2014 | | 2015 | | 2016 | |
|----------------------------------|---------|-------|---------|-------|---------|-------|
| | numër | % | numër | % | numër | % |
| Gjithsej | 112,537 | 100,0 | 152,288 | 100,0 | 160,679 | 100,0 |
| Shqiptare 100% | 107,291 | 95,3 | 146,349 | 96,1 | 155,042 | 96,5 |
| Të huaja e të përbashkëta | 5,246 | 4,7 | 5,939 | 3,9 | 5,637 | 3,5 |
| <i>nga të cilat</i> | | | | | | |
| Të huaja 100% | 3,479 | 3,1 | 4,084 | 2,7 | 4,024 | 2,5 |
| Të përbashkëta (Shqiptare+Huaja) | 1,767 | 1,6 | 1,855 | 1,2 | 1,613 | 1,0 |
| <i>nga të cilat</i> | | | | | | |
| Mbizotërim Shqiptar | 636 | 0,6 | 686 | 0,5 | 822 | 0,5 |
| Mbizotërim i huaj | 1,131 | 1,0 | 1,169 | 0,8 | 791 | 0,5 |

Burimi: INSTAT

Në vitin 2016 ndërmarrjet me origjinën nga shtetet e Bashkimit Evropian zënë 2,5 % të ndërmarrjeve aktive gjithsej në Shqipëri, dhe 70 % të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta.

Ndërmarrjet me origjinë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor përfaqësojnë 10,9 % dhe ndërmarrjet me origjinë nga shtetet e tjera zënë 19,1 % të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta.


Fig.1 Struktura e ndërmarrje të huaja e të përbashkëta sipas shteteve, 2016



Ndërmarrjet e mëdha të huaja e të përbashkëta janë të përqendruara kryesisht në aktivitetet ekonomike si call center, prodhimi i këpucëve dhe aktiviteti bankar.

Ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta me pronarë nga Greqia dhe Italia përfaqësojnë 56,5 % të ndërmarrje gjithsej.

Fig.2: Ndërmarrje të huaja dhe të përbashkëta sipas shteteve



Tab. 2 Ndërmarrje të huaja dhe të përbashkëta sipas shteteve¹

| Ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta | | 2014 | | | 2015 | | | 2016 | | |
|--------------------------------------|------------------------------|----------|------------------|------------------------------|----------|------------------|------------------------------|----------|------------------|------------------------------|
| | | Gjithsej | Të huaja 100% | Të huaja e të përbashkëta | Gjithsej | Të huaja 100% | Të huaja e të përbashkëta | Gjithsej | Të huaja 100% | Të huaja e të përbashkëta |
| TOTAL | | 5,246 | 3,479 | 1,767 | 5,939 | 4,084 | 1,855 | 5,637 | 4,024 | 1,613 |
| Shtetet e BE | Austria | 102 | 66 | 36 | 109 | 73 | 36 | 107 | 71 | 36 |
| | Britania e Madhe | 101 | 68 | 33 | 92 | 60 | 32 | 86 | 61 | 25 |
| | Gjermania | 146 | 96 | 50 | 152 | 101 | 51 | 115 | 61 | 54 |
| | Greqia | 640 | 366 | 274 | 675 | 400 | 275 | 522 | 314 | 208 |
| | Italia | 2,267 | 1,365 | 902 | 2,753 | 1,789 | 964 | 2,662 | 1,850 | 812 |
| | Të tjera BE | 467 | 321 | 146 | 453 | 316 | 137 | 452 | 331 | 121 |
| | Gjithsej shtetet e BE-së | 3,723 | 2,282 | 1,441 | 4,234 | 2,739 | 1,495 | 3,944 | 2,688 | 1,256 |
| Shtetet e Ballkanit Perëndimor | Bosnja&Hercegovina | 10 | c | c | 10 | c | c | 8 | c | c |
| | Serbia | 42 | 32 | 10 | 43 | 34 | 9 | 46 | 37 | 9 |
| | Kosova | 253 | 224 | 29 | 411 | 354 | 57 | 446 | 347 | 99 |
| | Mali i Zi | 33 | 27 | 6 | 27 | 21 | 6 | 14 | 10 | 4 |
| | Maqedonia | 135 | 99 | 36 | 116 | 87 | 29 | 100 | 82 | 18 |
| | Gjithsej shtetet e Ballkanit | 473 | 390 | 83 | 607 | 504 | 103 | 614 | 484 | 130 |
| Shtetet e tjera | Emiratet e Bashkuara Arabe | 37 | 23 | 14 | 31 | 20 | 11 | 59 | 52 | 7 |
| | Kanada | 24 | 19 | 5 | 47 | 28 | 19 | 18 | 15 | 3 |
| | Kina | 84 | 67 | 17 | 89 | 67 | 22 | 72 | 58 | 14 |
| | Sh. B. A | 156 | 110 | 46 | 152 | 103 | 49 | 133 | 89 | 44 |
| | Turqia | 415 | 338 | 77 | 461 | 375 | 86 | 434 | 355 | 79 |
| | Zvicra | 53 | 40 | 13 | 46 | 31 | 15 | 38 | 35 | 3 |
| | Të tjera | 281 | 210 | 71 | 272 | 217 | 55 | 325 | 248 | 77 |
| | Gjithsej shtete të tjera | 1,050 | 807 | 243 | 1,098 | 841 | 257 | 1,079 | 852 | 227 |

Burimi: INSTAT

Ndërmarrjet me pronësi 100 % të huajt përfaqësojnë 71,4 % të totalit të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta, ndërsa ndërmarrjet e përbashkëta me mbizotërim të huajt përfaqësojnë 14 % të totalit.

¹ c Detajimet e metejshme prekin konfidencialitetin.

Tab. 3 Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta sipas pronësisë dhe rajoneve

| Pronësia | 2014 | | | | 2015 | | | | 2016 | | | |
|--------------------------------------|----------|-----------------|--------------------------------|-----------------|----------|-----------------|--------------------------------|-----------------|----------|-----------------|--------------------------------|-----------------|
| | Gjithsej | Shtetet e BE-së | Shtetet e Ballkanit Perëndimor | Shtetet e tjera | Gjithsej | Shtetet e BE-së | Shtetet e Ballkanit Perëndimor | Shtetet e tjera | Gjithsej | Shtetet e BE-së | Shtetet e Ballkanit Perëndimor | Shtetet e tjera |
| Gjithsej | 5,246 | 3,723 | 473 | 1,050 | 5,939 | 4,234 | 607 | 1,098 | 5,637 | 3,944 | 614 | 1,079 |
| Të huaja 100% | 3,479 | 2,282 | 390 | 807 | 4,084 | 2,739 | 504 | 841 | 4,024 | 2,688 | 484 | 852 |
| Të përbashkëta (Shqiptarë + Të huaj) | 1,767 | 1,441 | 83 | 243 | 1,855 | 1,495 | 103 | 257 | 1,613 | 1,256 | 130 | 227 |
| Mbizotërim Shqiptar | 636 | 524 | 34 | 78 | 686 | 542 | 48 | 96 | 822 | 621 | 82 | 119 |
| Mbizotërim i Huaj | 1,131 | 917 | 49 | 165 | 1,169 | 953 | 55 | 161 | 791 | 635 | 48 | 108 |

Burimi: INSTAT

Në ekonominë shqiptare, ndërmarrjet nga Shtetet EU janë mbizotëruese në shërbime të tjera (24,3 %), tregti (18,6 %) dhe industri (13,6 %) ndaj totalit të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta.

Tab. 4 Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta sipas aktiviteti ekonomik dhe rajoneve

| Aktiviteti ekonomik | | Gjithsej | Prodhuesit e të mirave | Bujqësia, pyjet dhe peshkimi | Industria | Ndërtimi | Prodhuesit e shërbimeve | Tregtia | Transporti dhe magazinimi | Akomodimi dhe shërbimi ushqimor | Informacioni dhe komunikacioni | Shërbime të tjera |
|---------------------|--------------------------------|----------|------------------------|------------------------------|-----------|----------|-------------------------|---------|---------------------------|---------------------------------|--------------------------------|-------------------|
| 2014 | Gjithsej | 5,246 | 1,529 | 54 | 971 | 504 | 3,717 | 1,586 | 98 | 175 | 200 | 1,658 |
| | Shtetet e BE-së | 3,723 | 1,177 | 42 | 746 | 389 | 2,546 | 1,052 | 73 | 83 | 138 | 1,200 |
| | Shtetet e Ballkanit Perëndimor | 473 | 111 | 4 | 71 | 36 | 362 | 184 | 9 | 58 | 20 | 91 |
| | Shtetet e tjera | 1,050 | 241 | 8 | 154 | 79 | 809 | 350 | 16 | 34 | 42 | 367 |
| 2015 | Gjithsej | 5,939 | 1,738 | 66 | 1,139 | 533 | 4,201 | 1,812 | 117 | 188 | 245 | 1,839 |
| | Shtetet e BE-së | 4,234 | 1,302 | 53 | 858 | 391 | 2,932 | 1,224 | 86 | 97 | 181 | 1,344 |
| | Shtetet e Ballkanit Perëndimor | 607 | 150 | 4 | 95 | 51 | 457 | 236 | 14 | 54 | 26 | 127 |
| | Shtetet e tjera | 1,098 | 286 | 9 | 186 | 91 | 812 | 352 | 17 | 37 | 38 | 368 |
| 2016 | Gjithsej | 5,637 | 1,523 | 61 | 1,009 | 453 | 4,114 | 1,621 | 117 | 239 | 279 | 1,858 |
| | Shtetet e BE-së | 3,944 | 1,140 | 44 | 765 | 331 | 2,804 | 1,046 | 80 | 116 | 195 | 1,367 |
| | Shtetet e Ballkanit Perëndimor | 614 | 141 | 9 | 92 | 40 | 473 | 233 | 14 | 64 | 34 | 128 |
| | Shtetet e tjera | 1,079 | 242 | 8 | 152 | 82 | 837 | 342 | 23 | 59 | 50 | 363 |

Burimi: INSTAT

Sipas madhësisë së ndërmarrjeve, bazuar në numrin e të punësuarve, në vitin 2016 ndërmarrjet e vogla nga vendet e BE-së mbulonin 77,1 % të të gjitha ndërmarrjeve të BE-së, ndërsa kompanitë e mëdha mbulonin 1,3 %. Kjo përqindje e bizneseve të vogla dhe të mëdha lidhet me veprimtarinë ekonomike ku ata veprojnë.

Tab. 5 Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta sipas madhësisë së ndërmarrjes

| Madhësia e Ndërmarrjeve | 2014 | | | | 2015 | | | | 2016 | | | |
|-------------------------|----------|-----------------|--------------------------------|-----------------|----------|-----------------|--------------------------------|-----------------|----------|-----------------|--------------------------------|-----------------|
| | Gjithsej | Shtetet e BE-së | Shtetet e Ballkanit Perëndimor | Shtetet e tjera | Gjithsej | Shtetet e BE-së | Shtetet e Ballkanit Perëndimor | Shtetet e tjera | Gjithsej | Shtetet e BE-së | Shtetet e Ballkanit Perëndimor | Shtetet e tjera |
| Gjithsej | 5,246 | 3,723 | 473 | 1,050 | 5,939 | 4,234 | 607 | 1,098 | 5,637 | 3,944 | 614 | 1,079 |
| 01-04 | 3,754 | 2,624 | 388 | 742 | 4,260 | 3,034 | 462 | 764 | 4,359 | 3,042 | 507 | 810 |
| 05-09 | 631 | 445 | 52 | 134 | 697 | 469 | 79 | 149 | 466 | 300 | 54 | 112 |
| 10-49 | 567 | 413 | 31 | 123 | 645 | 465 | 55 | 125 | 505 | 363 | 42 | 100 |
| 50-249 | 224 | 192 | c | c | 263 | 214 | c | c | 233 | 187 | c | 37 |
| 250+ | 70 | 49 | c | c | 74 | 52 | c | c | 74 | 52 | c | c |

Burimi: INSTAT


B. Treguesit kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta²

Statistikat mbi ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta synojnë të monitorojnë rëndësinë, strukturën dhe performancën e këtyre ndërmarrjeve brenda territorit shqiptar.

Çfarë ndikimi?

Në vitin 2016, ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta kanë punësuar 16 % të punësimit gjithsej nga 17,7 % në vitin 2015. Shitjet neto të realizuara nga ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta përbëjnë 22,7 % të shitjeve neto të ndërmarrjeve rezidente në vitin 2016, ndërsa gjatë vitit të kaluar ky tregues ishte 24,6 %. Përqindja e investimeve të realizuara nga ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta është 46,9 % e investimeve gjithsej të vitit 2016, ndërsa në vitin 2015 ishte 42 %.

Fig.3: Përqindja e treguesve kryesorë në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët ndaj ndërmarrjeve shqiptare



Nga cilat vende?

Në vendet e BE-së, gjatë vitit 2016, Italia (49,6 % e punësimit dhe 25,2 % e shitjeve neto) dhe Greqia (10,9 % e punësimit dhe 13,2 % e shitjeve neto) janë dy shtetet me pjesën më të madhe të punësimit dhe shitjeve neto. Turqia mbulon 10,4 % të punësimit dhe 12,5 % të shitjeve neto dhe ka ndikimin më të madh në grupin e vendeve të tjera. Në vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova mbulon 2,9 % të punësimit dhe 2,9 % të shitjeve neto.

² Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve përfshin të gjitha format legale të ndërmarrjeve aktive që prodhojnë të mira e shërbime për treg por përjashton nga studimi aktivitetet e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit, aktivitetet financiare dhe të sigurimit, administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi social i detyrueshëm si edhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare.

Grupi i vendeve të tjera investuan 65,4 % të totalit të investimeve të kryera nga ndërmarrjet e huaja në vitin 2016. Pjesa më e madhe është investuar nga Zvicra (42,4 %). Për vendet e BE-së, Austria (14,8 %) dhe Italia (9,9 %) dominojnë në vlerën e investimeve të bëra gjatë vitit 2016, ndërsa për vendet e Ballkanit Perëndimor është Kosova (1,5 %).


Tab. 6 Struktura e treguesve kryesorë në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët sipas shteteve

| Ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët | | Të punësuarit | | | Shitjet | | | Investimet | | |
|--|--------------------------------|---------------|------|------|---------|------|------|------------|------|------|
| | | 2014 | 2015 | 2016 | 2014 | 2015 | 2016 | 2014 | 2015 | 2016 |
| Shtete të BE-së | Austria | 2,7 | 3,0 | 3,1 | 4,3 | 5,8 | 5,5 | 0,7 | 2,8 | 14,8 |
| | Britania e madhe | 0,7 | 5,0 | 0,3 | 2,0 | 4,1 | 0,2 | 0,3 | 1,9 | 0,1 |
| | Gjermania | 3,5 | 3,1 | 4,0 | 3,5 | 3,6 | 6,8 | 0,9 | 1,0 | 2,7 |
| | Greqia | 11,8 | 11,2 | 10,9 | 17,3 | 15,7 | 13,2 | 15,6 | 11,9 | 3,6 |
| | Italia | 50,5 | 48,4 | 49,6 | 22,7 | 22,2 | 25,2 | 18,2 | 12,1 | 9,9 |
| | Shtete të tjera të BE-së | 6,5 | 5,2 | 6,6 | 9,2 | 8,5 | 10,0 | 2,3 | 3,7 | 0,9 |
| | Gjithsej Shtete të BE-së | 75,7 | 75,9 | 74,6 | 59,1 | 60,0 | 60,9 | 38,0 | 33,4 | 32,0 |
| Shtete të Ballkanit Perëndimor | Bosnja & Hercegovina | 0,1 | 0,1 | 0,1 | 0,2 | 0,5 | 0,2 | 0,0 | 0,0 | 0,6 |
| | Serbia | 0,2 | 0,3 | 0,5 | 0,2 | 0,4 | 2,1 | 0,0 | 0,2 | 0,1 |
| | Kosova | 1,4 | 2,5 | 2,9 | 1,4 | 2,9 | 2,9 | 0,2 | 2,5 | 1,5 |
| | Mali i Zi | 0,1 | 0,1 | 0,2 | 0,9 | 0,3 | 0,5 | 0,0 | 0,0 | 0,0 |
| | Maqedonia | 0,5 | 0,6 | 0,5 | 0,7 | 0,8 | 1,5 | 0,4 | 0,1 | 0,4 |
| | Shtetet e Ballkanit Perëndimor | 2,3 | 3,6 | 4,1 | 3,4 | 4,8 | 7,3 | 0,7 | 2,8 | 2,6 |
| Shtete të tjera | Emiratet e Bashkuara Arabe | 1,0 | 0,8 | 0,3 | 1,7 | 1,0 | 0,4 | 1,7 | 0,1 | 0,2 |
| | Kanada | 2,0 | 1,5 | 1,4 | 11,3 | 9,0 | 6,6 | 50,0 | 21,6 | 1,5 |
| | Republika Popullore e Kinës | 0,3 | 0,4 | 0,8 | 0,4 | 0,3 | 1,3 | 0,0 | 0,6 | 0,3 |
| | Sh B A | 1,8 | 1,4 | 1,2 | 1,4 | 1,3 | 0,8 | 1,6 | 1,1 | 0,2 |
| | Turqi | 10,4 | 10,2 | 10,4 | 15,0 | 14,5 | 12,5 | 5,2 | 12,1 | 20,2 |
| | Zvicër | 1,5 | 0,8 | 1,0 | 3,0 | 3,0 | 3,5 | 2,3 | 3,0 | 42,4 |
| | Shtete të tjera | 4,9 | 5,4 | 6,1 | 4,7 | 6,1 | 6,8 | 0,5 | 25,2 | 0,5 |
| | Shtete të tjera gjithsej | 21,9 | 20,5 | 21,3 | 37,5 | 35,2 | 31,9 | 61,3 | 63,8 | 65,4 |

Burimi: INSTAT


Vendet e BE-së kanë pjesën më të madhe të punësimit në ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta; në vitin 2016 këto vende zënë 74,6 % të punësimit, ndërsa në vitin 2015 ky tregues ishte 75,9 %.

Fig. 4 Struktura e punësimit në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët



Përsa i përket shitjeve neto, situata duket e ngjashme me atë të punësimit. Vendet e BE-së kanë pjesën më të madhe të shitjeve neto në ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta me 60,9 % gjatë vitit 2016, nga 60,0 % në 2015.

Fig.5 Struktura e shitjeve neto në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët



Cilët sektorë?

Për treguesin e punësimit, përqindja më e lartë e ndërmarrjeve me pronësi të huaj dhe të përbashkët është në sektorin e Industrisë Përpunuese me 38,1 %, gjatë vitit 2016, e cila tregon një rritje prej 3,4 % krahasuar me vitin 2015.

Përsa i përket shitjeve neto, gjatë vitit 2016, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve me pronësi të huaj dhe të përbashkët është në sektorin e Tregtisë (22,3 %) duke u ulur me 1,9 % krahasuar me 2015 dhe në sektorin e Industrisë përpunuese (19 %) duke u rritur me 0,1 %.

Gjatë dy viteve të fundit, pjesa më e madhe e investimeve është realizuar në sektorin e Energjisë elektrike, gazit, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve respektivisht me 58,3 % në vitin 2016 dhe 32,9 % në 2015.

Tab. 7 Struktura e treguesve kryesorë sipas aktiviteteve ekonomike


| Viti | Treguesit | Aktiviteti ekonomik | Industri nxjerrëse | Industri përpunuese | Energji Elektrike dhe Ujë | Ndërtim | Tregti | Akomodim dhe Restorante | Transport Komunikacion | % |
|------|---------------|---------------------|--------------------|---------------------|---------------------------|---------|--------|-------------------------|------------------------|-----------|
| | | | | | | | | | | NVE Rev.2 |
| 2014 | Të punësuarit | | 6,1 | 38,1 | 1,5 | 5,7 | 11,4 | 1,3 | 6,9 | 29,0 |
| | Shitjet neto | | 16,4 | 19,2 | 5,3 | 8,2 | 26,5 | 0,5 | 12,5 | 11,4 |
| | Investimet | | 52,5 | 5,1 | 10,2 | 0,8 | 1,7 | 0,3 | 18,8 | 10,5 |
| 2015 | Të punësuarit | | 5,1 | 34,7 | 1,6 | 6,3 | 11,3 | 1,4 | 8,2 | 31,4 |
| | Shitjet neto | | 13,3 | 18,9 | 4,8 | 11,0 | 24,2 | 0,5 | 14,3 | 13,1 |
| | Investimet | | 25,9 | 8,0 | 32,9 | 4,3 | 4,3 | 0,0 | 13,9 | 10,6 |
| 2016 | Të punësuarit | | 3,8 | 38,1 | 1,9 | 5,6 | 9,0 | 1,8 | 7,7 | 32,1 |
| | Shitjet neto | | 9,2 | 19,0 | 7,3 | 11,6 | 22,3 | 0,5 | 15,3 | 14,8 |
| | Investimet | | 3,8 | 22,1 | 58,3 | 2,2 | 2,9 | 0,4 | 5,6 | 4,8 |

Burimi: INSTAT

Përsa i përket strukturës së punësimit për secilin aktivitet ekonomik sipas rajoneve, vërehet se ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët kanë pjesën më të madhe të punësimit në sektorin e Industrisë Përpunuese me 30 % dhe përqindja më e ulët është në sektorin e Akomodimit dhe Restoranteve me 2,6 %.

Vendet e BE-së kanë pjesën më të madhe të punësimit në sektorin e Industrisë Përpunuese me 27,2 %. Për vendet e Ballkanit Perëndimor pjesa më e madhe e punësimit është në sektorin e Ndërtimit me 1,8 % dhe për vendet e tjera, sektori i Industrisë nxjerrëse ka pjesën më të madhe të punësimit me 18,8 %.

Fig.6 Struktura e punësimit sipas rajoneve për çdo aktivitet ekonomik, 2016




Ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët kanë ndikim më të madh në treguesin e shitjeve neto krahasuar me punësimin në secilin prej aktiviteteve ekonomike.

Përqindja më e lartë e shitjeve neto të realizuara nga ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta krahasuar me ndërmarrjet shqiptare është në sektorin e Industrisë Nxjerrëse me 62,1 %, ku ndikimi më i madh është nga grupi i vendeve të tjera (57,8 %). Përqindja më e ulët e shitjeve neto për ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta është në sektorin e Akomodimit dhe Restoranteve me 5,2 %.

Vendet e BE-së dhe vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ndikimin më të madh të shitjeve neto në sektorin e Transportit, Informacionit dhe Komunikacionit, respektivisht me 32,8 % dhe 4,0 %.

Fig.7 Struktura e shitjeve neto sipas rajoneve për çdo aktivitet ekonomik, 2016



Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta, krahasuar me ndërmarrjet shqiptare, dominojnë për investimet e realizuara në sektorin e Energjisë Elektrike, Gazit, Ujit dhe Menaxhimit të Mbetjeve (64,5 %), sektorin e Industrisë nxjerrëse (64,3 %) dhe sektorin e Industrisë përpunuese (59 %).

Në sektorët e përmendur më lart, grupi i vendeve të tjera ka ndikimin më të madh në investimet gjithsej të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta.

Vendet e BE-së kanë ndikimin më të madh në sektorin e Transportit, Informacionit dhe Komunikacionit me 34,5 %.

Fig.8 Struktura e investimeve sipas rajoneve për çdo aktivitet ekonomik, 2016




Tabela e mëposhtme paraqet strukturën e shitjeve neto të realizuara nga ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta gjatë vitit 2016, sipas vendeve kryesore në çdo aktivitet ekonomik.

Në sektorin e Industrisë nxjerrëse, pjesa më e madhe e shitjeve neto realizohet nga ndërmarrjet e zotëruara nga grupi i vendeve të tjera (93,1 %) ku Kanadaja është vendi dominues me 70,8 %.

Për sektorin e Akomodimit dhe shërbimit ushqimor pjesa më e madhe e shitjeve neto realizohet përsëri nga ndërmarrjet e zotëruara nga grupi i vendeve të tjera (57,9 %) ku Turqia përfaqëson 19,2 %. Të gjitha aktivitetet e tjera dominohen nga vendet e BE-së. Italia dominon në sektorin e Industrisë përpunuese (37,3 %), Ndërtim (39,8 %), Tregti (28,6 %) dhe Shërbimet (37,1 %). Greqia dominon në sektorin e Transportit, Informacionit dhe Komunikacionit (33,7 %). Austria dominon në sektorin e Energjisë Elektrike, Gazit, Ujit dhe Menaxhimit të Mbetjeve (15,9 %).

Tab. 8 Struktura e shitjeve për ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët sipas shteteve për çdo aktivitet ekonomik

| Rajonet | Aktivitetet Ekonomike | Industri nxjerrëse | Industri përpunuese | Energji Elektrike & Ujë | Ndërtim | Tregti | Akomodim & Restorante | Transport & Komunikacion | Shërbime të tjera |
|--------------------------------|--------------------------------|--------------------|---------------------|-------------------------|---------|------------|-----------------------|--------------------------|--------------------------|
| | NveRev.2 | 05-09 | 10-32 | 35-39 | 41-43 | 45; 46; 47 | 55; 56 | 49-53; 58-63 | 33; 68-82; 85-96 excl 94 |
| Shtetet e BE-së | Austria | 0,0 | 0,6 | 15,9 | 12,2 | 4,0 | 26,0 | 1,0 | 11,0 |
| | Britania e madhe | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,2 | 0,0 | 0,3 | 0,5 |
| | Gjermania | 0,0 | 3,1 | 0,3 | 4,7 | 5,4 | 0,7 | 27,1 | 1,8 |
| | Greqia | 2,5 | 9,2 | 4,4 | 9,8 | 11,7 | 0,5 | 33,7 | 13,6 |
| | Italia | 0,9 | 37,3 | 7,0 | 39,8 | 28,6 | 7,5 | 6,4 | 37,1 |
| | Shtete të tjera të BE-së | 2,4 | 10,7 | 48,7 | 0,7 | 13,0 | 2,5 | 1,8 | 6,5 |
| | Gjithsej Shtetet e BE-së | 5,8 | 61,0 | 76,3 | 67,2 | 62,9 | 37,3 | 70,3 | 70,4 |
| Shtetet e Ballkanit Perëndimor | Bosnja & Hercegovina | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,5 | 0,0 | 0,0 | 0,8 |
| | Serbia | 0,1 | 7,3 | 0,0 | 1,4 | 1,9 | 0,0 | 0,4 | 0,6 |
| | Kosova | 0,9 | 0,4 | 0,0 | 4,7 | 4,4 | 4,5 | 7,0 | 0,8 |
| | Mali i Zi | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 1,8 | 0,0 | 0,6 | 0,1 |
| | Maqedonia | 0,0 | 0,3 | 0,0 | 0,0 | 5,7 | 0,3 | 0,5 | 0,5 |
| | Shtetet e Ballkanit Perëndimor | 1,0 | 8,0 | 0,0 | 6,2 | 14,3 | 4,8 | 8,6 | 2,8 |
| Shtete të tjera | Emiratet e Bashkuara Arabe | 0,1 | 0,7 | 0,8 | 0,0 | 0,8 | 0,0 | 0,0 | 0,0 |
| | Kanada | 70,8 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,7 |
| | Republika Popullore e Kinës | 11,3 | 0,1 | 0,0 | 0,0 | 0,6 | 0,0 | 0,9 | 0,0 |
| | Sh B A | 0,0 | 0,5 | 0,0 | 0,5 | 0,0 | 7,0 | 3,4 | 0,5 |
| | Turqi | 0,4 | 18,5 | 13,7 | 20,1 | 7,1 | 19,2 | 15,4 | 10,8 |
| | Zvicër | 1,9 | 0,0 | 3,9 | 0,0 | 10,8 | 0,0 | 0,0 | 3,8 |
| | Shtete të tjera | 8,6 | 11,2 | 5,3 | 6,1 | 3,5 | 31,7 | 1,5 | 10,9 |
| | Shtete të tjera gjithsej | 93,1 | 31,0 | 23,7 | 26,7 | 22,8 | 57,9 | 21,2 | 26,8 |


Burimi: INSTAT

Cilat janë karakteristikat e ndërmarrjeve me pronësi të huaj dhe të përbashkët?

Gjatë vitit 2016, ndërmarrjet me 50 dhe më shumë të punësuar zënë 30,3 % të të punësuarve gjithsej dhe kanë realizuar 29,3 % të shitjeve neto dhe 47,3 % të investimeve gjithsej.

Ndërmarrjet me 1-4 të punësuar kanë ndikimin e dytë më të madh në shitjet neto me 26,7 %. Për treguesit e tjerë, ndikimin e dytë më të madh e kanë realizuar ndërmarrjet me 10-49 të punësuar me respektivisht 11,2 % të punësimit gjithsej dhe 55,9 % të investimeve gjithsej.

Fig.9 Përqindja e treguesve kryesorë sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2016



C. Investimet e Huaja Direkte (IHD)

Investimet e Huaja Direkte janë një faktor kryesor i integritit ekonomik ndërkombëtar dhe globalizimit. Statistikat e besueshme të IHD-ve kanë qenë gjithmonë thelbësore për hartuesit e politikave që përballen me sfidat e tërheqjes dhe shfrytëzimit të investimeve të huaja.

Tab. 9 IHD, Stoku sipas vendeve (mil Euro)

| IHD | 2014 | 2015 | 2016 |
|------------------|---------|---------|---------|
| Stoku gjithsej | 4,565.9 | 4,981.7 | 5,677.3 |
| EU-28 | 2,970.0 | 3,289.3 | 3,365.8 |
| Austria | 358.4 | 386.9 | 359.6 |
| Britania e Madhe | 20.8 | 23.8 | 38.4 |
| Gjermania | 129.5 | 137.2 | 122.7 |
| Greqia | 1,179.6 | 1,204.8 | 1,232.6 |
| Italia | 523.7 | 547.5 | 604.4 |
| Hollanda | 506.0 | 702.8 | 718.0 |
| Të Tjera EU | 252.1 | 286.4 | 290.1 |
| Zvicra | 79.4 | 120.6 | 550.1 |
| Kanada | 725.3 | 691.4 | 739.5 |
| SH B A | 88.4 | 94.5 | 80.8 |
| Të tjera | 702.8 | 785.9 | 941.0 |

Burimi: Banka e Shqipërisë

Stoku i IHD është rritur me 14 %, në 2016 krahasuar me 2015. Në fund të vitit 2016, vendet e BE-së përbënin pjesën më të madhe të Stokut (59,3 %), të dominuara nga Greqia dhe Hollanda respektivisht me 21,7 % dhe 12,6 %.

Tab. 10 IHD, Flow sipas vendeve (mil Euro)

| IHD | 2014 | 2015 | 2016 |
|------------------|-------|-------|-------|
| Flow gjithsej | 869.2 | 890.4 | 942.5 |
| EU-28 | 268.1 | 321.9 | 241.6 |
| Austria | -11.9 | 23.1 | 23.1 |
| Britania e Madhe | 4.8 | 11.9 | 6.5 |
| Gjermania | 21.9 | 7.1 | 18.7 |
| Greqia | 118.5 | 41.0 | 10.3 |
| Italia | 37.8 | 11.2 | 45.7 |
| Të Tjera EU | 96.9 | 227.7 | 137.3 |
| Zvicra | 73.7 | 146.0 | 432.6 |
| Kanada | 398.7 | 228.0 | 134.8 |
| SH B A | 35.3 | 3.5 | 10.2 |
| Të tjera | 93.4 | 191.0 | 123.4 |

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fluksi i IHD është rritur me 5,9 % në 2016 krahasuar me 2015. Për 2016, Zvicra ka patur rritjen më të madhe me gati 3 herë ndërsa Kanadaja rënien më të madhe me 40,9 %, krahasuar me 2015.

Tab.11 IHD, Stoku sipas aktiviteteve (mil Euro)

| IHD | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|--------|--------|--------|
| Stoku gjithsej | 4565.9 | 4981.7 | 5677.2 |
| B-Industria nxjerrëse | 642.9 | 635.1 | 651.8 |
| C-Industria përpunuese | 555.2 | 574.3 | 607.3 |
| (D+E)-Energjia elektrike, gazi, avulli, furnizimi me ujë, etj | 403.8 | 628.7 | 1109.1 |
| J-Informacioni dhe komunikacioni | 1180.1 | 1217.1 | 1214.5 |
| K- Aktivitete financiare dhe të sigurimit | 771.7 | 857.3 | 936.5 |
| Të tjera | 1012.0 | 1069.2 | 1158.0 |

Burimi: Banka e Shqipërisë

Sektori i "Informacionit dhe komunikimit" dhe "Energjia elektrike, gazi dhe furnizimi me ujë" përbënin vlerat më të larta të Stokut në fund të vitit 2016, përkatësisht me 21,4 % dhe 19,5 %.

Tab. 12 IHD, Flow sipas aktiviteteve (mil Euro)

| IHD | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|-------|-------|-------|
| Flow gjithsej | 869.2 | 890.4 | 942.5 |
| B-Industria nxjerrëse | 503.9 | 322.9 | 157.6 |
| C-Industria përpunuese | 37.5 | 20.0 | 54.2 |
| (D+E)-Energjia elektrike, gazi, avulli, furnizimi me ujë, etj | 67.7 | 339.5 | 565.1 |
| J-Informacioni dhe komunikacioni | 104.9 | 40.8 | -15.7 |
| K-Aktivitete financiare dhe të sigurimit | 34.2 | 80.4 | 72.4 |
| Të tjera | 121.1 | 86.8 | 108.8 |

Burimi: Banka e Shqipërisë

Sektori i "Energjisë elektrike, gazit dhe ujit" dhe "Industria Nxjerrëse" përbënin vlerat më të larta të Fluksit të IHD gjatë vitit 2016, përkatësisht me 60 % dhe 16,7 %.

D. Tregtia e Mallrave sipas Ndërmarrjeve

Ky kapitull ka si qëllim të prodhojë statistika të reja për karakteristikat e shkëmbimit të mallrave në Shqipëri për periudhën 2014-2016, për ndërmarrjet private me pronësi të huaj dhe të përbashkët.

Në vitin 2016, numri i ndërmarrjeve eksportuese me pronësi italiane është 316 dhe numri i ndërmarrjeve importuese me pronësi italiane është 619. Në 2016 numri i ndërmarrjeve eksportuese me pronësi greke është 89 dhe numri i ndërmarrjeve importuese me pronësi greke është 183.

Tab. 13 Numri i ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta sipas vendeve

| | | Eksportet | | | Importet | | |
|-------------------------------|----------------------------|-----------|------|------|----------|------|------|
| | | 2014 | 2015 | 2016 | 2014 | 2015 | 2016 |
| Vendet e BE-së | Austria | 25 | 20 | 25 | 35 | 37 | 39 |
| | Franca | 8 | 9 | 13 | 14 | 20 | 21 |
| | Gjermania | 22 | 21 | 21 | 48 | 45 | 47 |
| | Greqia | 106 | 97 | 89 | 186 | 177 | 183 |
| | Italia | 279 | 315 | 314 | 532 | 601 | 619 |
| | Hollanda | 11 | 10 | 8 | 20 | 19 | 16 |
| | Mbretëria e Bashkuar | 5 | 5 | 4 | 18 | 17 | 14 |
| | Të tjera të BE-së | 30 | 28 | 41 | 77 | 74 | 87 |
| Vendet e Ballkanit Perëndimor | Bosnja dhe Hercegovina | c | c | 3 | 4 | 4 | 5 |
| | Kosova | 15 | 26 | 27 | 40 | 59 | 86 |
| | Maqedonia | 14 | 12 | 7 | 26 | 21 | 25 |
| | Mali i Zi | c | - | c | c | c | c |
| | Serbia | 4 | 8 | 7 | 10 | 13 | 13 |
| Vendet e tjera | Kanada | 5 | c | 3 | 8 | 7 | 6 |
| | Kina | 5 | 4 | 5 | 18 | 17 | 15 |
| | Zvicra | 10 | 8 | 8 | 17 | 16 | 16 |
| | Turqia | 27 | 33 | 41 | 75 | 102 | 99 |
| | Emiratet e Bashkuara Arabe | 10 | 8 | 4 | 14 | 10 | 4 |
| | SHBA | 8 | 13 | 9 | 29 | 27 | 27 |
| | Vendet e tjera | 29 | 28 | 38 | 54 | 56 | 76 |

Burimi: INSTAT

Në vitin 2016, Italia ka zënë pjesën më të madhe të vlerës së eksporteve (54,6 %), Kanadaja (16,4 %) dhe Greqia (6,5 %). Italia, gjithashtu ka zënë pjesën më të madhe të vlerës së importeve (36,6 %), e ndjekur nga Zvicra (11,2 %), Greqia (10,9 %) dhe Turqia (9,4 %).

Tab.14 Eksportet dhe importet e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në totalin e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, sipas vendeve

| | | Eksporti | | | Importi | | | % |
|-------------------------------|----------------------------|----------|------|------|---------|------|------|---|
| | | 2014 | 2015 | 2016 | 2014 | 2015 | 2016 | |
| Vendet e BE-së | Austria | 0,2 | 0,1 | 0,9 | 2,9 | 3,0 | 4,2 | |
| | Franca | 0,8 | 0,7 | 1,0 | 1,3 | 1,7 | 7,2 | |
| | Gjermania | 1,0 | 1,4 | 1,9 | 2,1 | 2,7 | 3,9 | |
| | Greqia | 4,4 | 5,4 | 6,5 | 11,7 | 12,3 | 10,9 | |
| | Italia | 39,1 | 45,7 | 54,6 | 34,7 | 39,9 | 36,6 | |
| | Hollanda | 0,1 | 0,2 | 0,0 | 1,3 | 1,8 | 2,0 | |
| | Mbretëria e Bashkuar | 1,7 | 4,2 | 0,0 | 1,1 | 0,7 | 0,1 | |
| | Të tjera të BE-së | 0,9 | 1,9 | 3,7 | 5,4 | 5,5 | 3,8 | |
| Vendet e Ballkanit Perëndimor | Bosnja dhe Hercegovina | c | c | 0,0 | 0,1 | 0,1 | 0,2 | |
| | Kosova | 0,2 | 2,5 | 1,0 | 0,9 | 2,1 | 1,1 | |
| | Maqedonia | 0,2 | 0,4 | 0,2 | 0,4 | 0,4 | 0,8 | |
| | Mali i Zi | c | - | c | c | c | c | |
| | Serbia | 0,0 | 0,0 | 0,7 | 0,2 | 0,4 | 2,3 | |
| Vendet e tjera | Kanada | 33,3 | c | 16,4 | 11,5 | 7,0 | 2,1 | |
| | Kina | 0,1 | 0,1 | 0,2 | 0,2 | 0,5 | 0,3 | |
| | Liban | 3,0 | 3,1 | 3,4 | 1,2 | 0,9 | 0,7 | |
| | Zvicra | 0,3 | 0,5 | 0,9 | 3,2 | 2,4 | 11,2 | |
| | Turqia | 11,3 | 9,4 | 5,9 | 15,5 | 11,4 | 9,4 | |
| | Emiratet e Bashkuara Arabe | 1,7 | 1,7 | 1,3 | 3,4 | 2,9 | 1,2 | |
| | SHBA | 0,7 | 0,8 | 0,3 | 1,2 | 1,0 | 0,5 | |
| | Vendet e tjera | 1,0 | 0,4 | 1,0 | 1,6 | 3,2 | 1,4 | |

Burimi: INSTAT

Për vitin 2016, eksportet e ndërmarrjet të huaja dhe të përbashkëta përbënin 48,2 %, të eksporteve, nga 58,8 % në vitin 2015. Ndërsa, importet e këtyre ndërmarrjeve përbënin 29 %, të importeve, nga 28,7 % në vitin 2015.

Tab. 15 Struktura eksport / import e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në totalin e ndërmarrjeve.

%

| Madhësia e ndërmarrjeve | Aktiviteti (NVE Rev.2) | | | | | | | | | | | |
|-------------------------|------------------------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|
| | 2014 | | | | 2015 | | | | 2016 | | | |
| | | B-E | G | | | B-E | G | | | B-E | G | |
| | Totali | Industri | Tregti | Të tjera | Totali | Industri | Tregti | Të tjera | Totali | Industri | Tregti | Të tjera |
| Eksportet | | | | | | | | | | | | |
| Totali | 62,9 | 72,1 | 15,2 | 31,3 | 58,8 | 65,7 | 29,1 | 35,0 | 48,2 | 51,1 | 28,8 | 57,4 |
| 1-9 | 37,4 | 49,1 | 29,8 | 23,3 | 56,6 | 51,9 | 64,7 | 19,8 | 47,7 | 58,3 | 44,1 | 21,3 |
| 10-49 | 21,2 | 29,3 | 8,0 | 59,4 | 30,7 | 41,0 | 12,7 | 30,2 | 25,7 | 27,0 | 16,8 | 51,0 |
| 50-249 | 50,0 | 53,0 | 26,8 | 1,8 | 47,0 | 50,7 | c | c | 47,5 | 48,1 | 11,2 | 86,6 |
| 250+ | 84,5 | 88,6 | 2,4 | 43,5 | 75,9 | 81,1 | c | c | 58,2 | 59,3 | - | 84,3 |
| Importet | | | | | | | | | | | | |
| Totali | 30,7 | 58,3 | 12,5 | 39,3 | 28,7 | 53,1 | 12,9 | 34,5 | 29,0 | 49,3 | 13,2 | 46,9 |
| 1-9 | 19,4 | 55,9 | 10,7 | 36,4 | 19,7 | 44,9 | 12,6 | 26,5 | 29,2 | 52,4 | 16,5 | 58,9 |
| 10-49 | 18,5 | 37,3 | 13,6 | 29,1 | 18,1 | 26,7 | 15,4 | 24,1 | 22,0 | 45,4 | 12,9 | 28,6 |
| 50-249 | 26,5 | 48,8 | 11,6 | 15,2 | 28,5 | 51,6 | c | c | 28,8 | 48,3 | c | c |
| 250+ | 62,2 | 70,2 | 15,9 | 67,6 | 53,2 | 69,2 | c | c | 43,1 | 52,5 | c | c |

Burimi: INSTAT

Për vitin 2016, eksportet e ndërmarrjeve nga BE përbënin 68,7 %, të eksporteve të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, nga 59,7 % në vitin 2015. Ndërsa, importet e këtyre ndërmarrjeve përbënin 68,7 %, të importeve, nga 67,6 % në vitin 2015.

Tab. 16 Struktura eksport / import e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta nga BE në totalin e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta

%

| Madhësia e ndërmarrjeve | Aktiviteti (NVE Rev.2) | | | | | | | | | | | |
|-------------------------|------------------------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|
| | 2014 | | | | 2015 | | | | 2016 | | | |
| | | B-E | G | | | B-E | G | | | B-E | G | |
| | Totali | Industri | Tregti | Të tjera | Totali | Industri | Tregti | Të tjera | Totali | Industri | Tregti | Të tjera |
| Eksportet | | | | | | | | | | | | |
| Totali | 48,2 | 46,8 | 79,0 | 71,7 | 59,7 | 57,2 | 87,2 | 59,9 | 68,7 | 70,2 | 63,8 | 44,3 |
| 1-9 | 68,4 | 70,2 | 66,5 | 64,4 | 90,8 | 92,9 | 89,9 | 86,4 | 68,8 | 73,7 | 63,9 | 76,7 |
| 10-49 | 94,2 | 94,6 | 92,5 | 94,0 | 68,5 | 66,2 | 73,8 | 92,8 | 80,6 | 88,3 | 65,1 | 61,5 |
| 50-249 | 82,8 | 82,3 | c | c | 82,0 | 81,8 | c | c | 87,6 | 91,4 | 56,0 | 33,5 |
| 250+ | 34,4 | 34,3 | c | c | 45,1 | 45,4 | c | c | 53,1 | 53,4 | - | 24,9 |
| Importet | | | | | | | | | | | | |
| Totali | 60,5 | 56,9 | 68,8 | 65,4 | 67,6 | 67,6 | 67,6 | 68,0 | 68,7 | 68,2 | 70,0 | 68,6 |
| 1-9 | 76,1 | 86,9 | 69,6 | 67,7 | 80,9 | 88,3 | 73,8 | 83,6 | 78,3 | 53,9 | 77,7 | 95,6 |
| 10-49 | 59,6 | 63,9 | 54,2 | 76,4 | 60,0 | 61,5 | 58,4 | 68,2 | 39,5 | 22,2 | 58,9 | 52,3 |
| 50-249 | 79,7 | 77,2 | 89,0 | 70,9 | 80,0 | 79,1 | c | c | 87,0 | 94,4 | 77,0 | 49,7 |
| 250+ | 47,9 | 44,2 | 100 | 59,4 | 58,5 | 58,0 | c | c | 68,9 | 76,0 | - | 46,1 |

Burimi: INSTAT